

KONTRATË BINJAKËZIMI

Përkrahje për Statistikat

Kosovë



RAPORTI I MISIONIT

mbi

2.3.1.2 Vazhdim i përkrahjes në implementimin e Planit të Veprimit

Komponenti nr. 2 Llogaritë Kombëtare

Misioni i udhëhequr nga Clementina Ivan-Ungureanu,

Statistikat e Danimarkës

17-21 Nëntor 2014

IPA 2012

Clementina Ivan-Ungureanu

Statistics Denmark

Sejrøgade 11

DK-2100 Copenhagen Ø

Denmark

Tel: +

Email: clementina@ivan-ungureanu.ro

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.
1. Komentet e përgjithshme	6
2. Vlerësimet dhe rezultatet.....	6
3. Konkluzionet dhe Rekomandimet.....	7
Aneksi 1.....	9
Aneksi 2. Personat e takuar	13

Lista e Shkurtesave

ANA	Llogaritë Vjetore Kombëtare
BoPs	Bilanci i Pagesave
BEC	Kategoritë e Mëdha Ekonomike
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
KKF	Konsumi i Kapitalit Fiks
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
ESA 95	Sistemi Evropian i Llogarive 95
ESA 2010	Sistemi Evropian i Llogarive 2010
BE	Bashkimi Evropian
BPV	Bruto Prodhimi Vendor
FBFK	Formimi Bruto Kapitalit Fiks
KFQ	Konsumi Final i Qeverisë
SHKFEF	Shpenzimet e Konsumit Final të Ekonomive Familjare
IC	Konsumi i Ndërmjetëm
IÇIM	Indeksi i Çmimeve të Importit
IPA	Instrumenti Para Asociim-Stabilizimit
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
TI	Teknologjia Informatike
AFP	Anketa e Fuqisë Punëtore
LLKT	Llogaritë Kombëtare Tremujore
BPVT	BPV Tremujor
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
MOU	Memorandum i Mirëkuptimit
LLK	Llogaritë Kombëtare
NACE rev.1	Nomenklatura e veprimtarive ekonomike, rev. 1
NACE rev.2	Nomenklatura e veprimtarive ekonomike, rev. 2
DLLK	Departamenti i Llogarive Kombëtare

IJPSHEF	Institucionet Jo-Profitabile që i Shërbejnë Ekonomive Familjare
NOE	Ekonomia e Pavrojtuar
OJQ	Organizatat Jo Qeveritare
IÇP	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit
R&D	Kërkimi dhe Zhvillimi
SIDA	Agjencioni Ndërkombëtar Suedez për Zhvillim dhe Bashkëpunim
ASN	Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve
STS	Statistikat Afatshkurt
SUT	Tabelat ofruese-Përdoruese
TeR	Termet e Referencës

Përmbledhje Ekzekutive

Misioni aktual në komponentin 2 – Llogaritë Kombëtare të projektit të binjakëzimit ka pasur si objektiv kryesor përkrahjen e ASK-së për vlerësimin e BPV-së vjetore sipas qasjes së prodhimit, në çmime aktuale dhe konstante, për vitin 2013 dhe publikimin e serisë kohore të rishikuar, për vitet 2008-2012.

Gjatë këtij viti, ASK ka implementuar ESA 2010 në llogaritë kombëtare; aktivitetet kanë qenë të fokusuara në vlerësimin e kërkimit dhe zhvillimit (R&D), sistemin e armëve, sigurimit të jo-jetës, FISIM-it dhe outputin e Bankës Qendrore bazuar në kërkesat e metodologjisë së re. Vlerësimet janë bërë për periudhën 2008-2012. Vlerësimet kanë vazhduar bazuar në të njëjtën metodologji dhe rezultatet janë përfshirë në BPV të vitit 2013.

Gjatë implementimit të ESA 2010, rishikimi i BPV-së vjetore sipas qasjes së prodhimit dhe shpenzimeve, në çmime aktuale dhe konstante, është realizuar për periudhën 2008-2012. Rishikimi ka përfshirë këto vlerësime: (i) outputin dhe konsumin e ndërmjetëm të njësive jo-financiare të bazuara në të dhënat e ASN-së; (ii) outputin e qeverisë (përfshirë metodën e re për kalkulimin e KKF), (iii) Konsumin Final të Ekonomive Familjare (KFEF) të bazuar në qasjen e fluksit të mallrave; (iv) qeraja e imputuar duke përdorur qasjen e kostove, bazuar në të dhënat e ofruara nga Regjistrimi i Popullsisë, Banesave dhe Ekonomive Familjare; dhe (v) çmimet konstante të outputit të qeverisë dhe taksat mbi produktet. Gjatë misionit të kaluar, qe është realizuar në periudhën 1-5 Shtator të vitit 2014, është diskutuar rreth vlerësimeve të reja të BPV-së sipas qasjes së prodhimit dhe shpenzimeve dhe janë dhënë rekomandimet për përmirësime (shih raportin e misionit).

Gjatë misionit aktual janë finalizuar vlerësimet e BPV të vitit 2013 sipas qasjes së prodhimit në çmime aktuale dhe konstante dhe ASK i ka publikuar ato me 25 Nëntor të vitit 2014, bashkë me serinë kohore të rishikuar. Kalkulimet janë bërë bazuar në burimet e të dhënave në dispozicion, që do të thotë në bazë të qarkullimit të ndërmarrjeve të ofruara nga Administrata Tatimore, pasqyrat financiare të njësive financiare (Banka Qendrore, bankave tjera komerciale dhe kompanive të sigurimit) dhe të dhënave statistikore (çmimet si IÇP, IÇK dhe çmimeve të bujqësisë). Burimi kryesor i të dhënave për përpilimin e BPV-së vjetore sipas qasjes së prodhimit, Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve (ASN), nuk është finalizuar dhe nuk ka qenë e mundur që këto rezultate të përdoren për vlerësimin e llogarive kombëtare. Për këtë arsye, vlerësimet për vitin 2013 konsiderohen të përkohshme.

Aktualisht, ekziston një interval kohor në mes të diseminimit të BPV-së sipas qasjes së prodhimit dhe të shpenzimeve; zakonisht, BPV sipas shpenzimeve publikohet në Shtator ndërsa sipas prodhimit publikohet dy muaj më vonë. Për vitin e ardhshëm, ASK ka planifikuar të përmirësojë vlerësimet dhe të publikojë BPV-në e përkohshme për vitin 2014, sipas dy qasjeve në Qershor të vitit 2015 (si shumë e BPV-së tremujor) dhe versionin gjysmë final në Nëntor të vitit 2015. Për të arritur këtë objektiv, është rekomanduar fuqishëm të

përmirësohet cilësia dhe afati kohor i ASN-së, në mënyrë që të përdoret në përpilimin e llogarive kombëtare.

1. Komentet e përgjithshme

Ky raport i misionit është përgatitur në kuadër të Projektit të Binjakëzimit „Përkrahje për Statistikat”.

Objektiv konkret i misionit ishte përkrahja e ASK-së për vlerësimin e BPV-së për vitin 2013 sipas prodhimit, në çmime aktuale dhe konstante.

Këndvështrimet dhe vëzhgimet e paraqitura në këtë raport janë ato të konsulentëve dhe jo domosdoshmërisht përpunohen me këndvështrimet e BE-së, ASK-së apo Statistikave të Danimarkës dhe partnerëve të tjerë (NI-CO/Statistikat e Finlandës/Istat/Statistikat e Lituanisë).

2. Vlerësimi dhe rezultatet

Vlerësimi i BPV-së sipas qasjes së prodhimit ka filluar në kornizën e IPA 2010, e realizuar në periudhën Prill 2011 – Shtator 2012; BPV-ja në çmime aktuale dhe konstante është elaboruar për periudhën 2008-2011. Për kalkulimin e BPV-së për vitin 2012, ASK ka pasur ndihmë teknike nga FMN-ja. Vitin e kaluar, këshilltari i FMN-së ka propozuar metoda të reja të vlerësimit të outputit dhe të konsumit të ndërmjetëm, bazuar në të dhënat e ASN-së dhe ka filluar rishikimin e BPV-së sipas qasjeve të prodhimit dhe të shpenzimeve për periudhën 2008-2012. Të dhënat e rishikuara kanë qenë në dispozicion në fillim të Shtatorit të vitit 2014. Problemet kryesore të të dhënave të rishikuara janë paraqitur në raportin e misionit të kaluar, të realizuar në periudhën 1-5 Shtator të vitit 2014.

Misioni aktual është fokusuar në vlerësimin e BPV-së sipas qasjes së prodhimit, në çmime aktuale dhe konstante për vitin 2013 dhe përmirësimin e të dhënave të rishikuara, që është bërë. Vlerësimet janë bazuar në burimet e të dhënave në dispozicion. Burimet kryesore të përdorura për vlerësimet ishin:

- Qarkullimi i njësive jo-financiare, i siguruar nga Administrata Tatimore;
- Pasqyrat financiare të njësive financiare (Banka Qendrore e Kosovës, bankat e tjera komerciale, kompanitë e sigurimit);
- Pasqyrat financiare të qeverisë në lidhje me shpenzimet dhe të ardhurat, të siguruara nga Ministria e Financave;
- Të dhënat statistikore në lidhje me çmimet (Indeksi i Çmimit të Prodhimit (IÇP), Indeksi i Çmimit të Konsumit (IÇK), Indeksi i Çmimit të Importit (IÇIMP) dhe çmimet e bujqësisë.

ASN për vitin 2013 është realizuar në periudhën Korrik-Shtator të vitit 2014, por rezultatet nuk kanë qenë në dispozicion në kohën kur zhvillohej misioni prandaj nuk ka qenë e mundur të përdoren për vlerësimet e BPV-së. Në këto kushte, burimi i vetëm në dispozicion për vlerësimin e outputit për aktivitetet jo-financiare ka qenë vlera e qarkullimit, e siguruar nga Administrata Tatimore.

Qarkullimi i vitit 2013, i detajuar sipas aktivitetit, bazuar në NACE rev.1 në nivel 2 shifror, është analizuar duke e krahasuar me vitin e kaluar; për disa aktivitete ka pasur jokonsistencë në të dhëna. Për shembull, në aktivitetin 13 të NACE rev.1, *Nxjerrja e metaleve*, vlera e qarkullimit ka rënë prej 156.9 milion euro në vitin 2013, në 94.3 milion euro në vitin 2012; në aktivitetin 21 *Prodhimi i metaleve bazike*, qarkullimi i vitit 2013 ka qenë gati dyfishë në vitin 2012 (11.2 milion, respektivisht 21.0 milion euro). Mund të ndodhë që disa ndërmarrje të mëdha janë klasifikuar në aktivitete të ndryshme në databazë nga Administrata Tatimore, por nuk ka qenë e mundur të verifikohet kjo hipotezë; i vetmi person në ASK që ka qasje në databazën e ATK-së ishte në trajnim në Paris. Për shkak të këtyre kushteve, vlerësimi i outputit është bazuar në vlerat e vitit të kaluar, në çmimet korresponduese (IÇP dhe IÇK) dhe shkallën nominale të rritjes së qarkullimit.

Outputi i qeverisë është vlerësuar bazuar në qasjen e kostos duke përdorur informatat e detajuara nga Ministria e Financave. Outputi i sektorit financiar është vlerësuar në bazë të të dhënave të ofruara nga Banka Qendrore të Kosovës; FISIM është kalkuluar duke u bazuar në metodologjinë e caktuar për implementimin e ESA 2010 dhe e gatshme për përdoruesit. Për shkak të mungesës së informacioneve në lidhje me IJPSHEF nga Ministria e Shërbimeve Publike, outputi është vlerësuar bazuar në IÇK-në korresponduese dhe duke marrë në konsideratë shkallën e rritjes reale në të njëjtin nivel si vitin e kaluar.

Pasi nuk kishte informata në dispozicion nga ASN-ja në lidhje me konsumin e ndërmjetëm të aktiviteteve jo-financiare, kjo është vlerësuar bazuar në pjesën/përqindjen e tij në outputin nga viti i kaluar.

Vlerësimet e outputit të vitit 2013 në çmimet e vitit të kaluar janë bërë duke përdorur IÇP-në dhe IÇK-në korresponduese; për konsumin e ndërmjetëm është përdorur raporti IC/O.

Seritë kohore dhe vlerësimet për vitin 2013 të BPV-së sipas qasjes së prodhimit janë realizuar duke përdorur NACE rev.1. Bazuar në tabelën e tranzicionit të realizuar gjatë misionit të udhëhequr në periudhën 25-29 Gusht të vitit 2014, të dhënat janë konvertuar në NACE rev.2. Konvertimi është realizuar për çmimet aktuale dhe konstante.

3. Konkluzionet dhe rekomandimet

Gjatë misionit, janë ofruar rekomandime të detajuara sa i përket vlerësimit të BPV-së vjetore. Është rekomanduar të përmirësohen vlerësimet e BPV-së sipas qasjes së prodhimit për vitin 2013 kur të jenë në dispozicion burimet e reja të të dhënave do (sidomos ASN) dhe të publikohen rezultatet.

Rishikim i plotë i BPV-së sipas qasjeve të prodhimit dhe shpenzimeve, në çmime aktuale dhe konstante për periudhën 2008-2013 ka paraqitur vështirësi të mëdha për ASK-në, për shkak të ndryshimeve të mëdha dhe stafit në dispozicion. Rishikimi kishte të bënte me implementimin e metodave të reja të vlerësimit nga FMN-ja dhe ndryshimet metodologjike të ESA 2010. Të dhënat e rishikuara kanë shumë mospërputhje; nuk kishte kohë, për shkak të kufizimeve kohore të publikimit të të dhënave, për të analizuar më thellë rezultatet dhe të përmirësohen vlerësimet. Për këtë arsye, është rekomanduar fuqishëm të vazhdohet me analizimin e të dhënave dhe të përmirësohen vlerësimet e BPV-së, me çmime aktuale dhe konstante për periudhën 2008-2013.

Është rekomanduar të përmirësohet organizimi i punës në statistikat ekonomike vjetore. Rezultatet e ASN-së, qe është burimi kryesor i të dhënave për vlerësimet vjetore të BPV-së, nuk ishin në dispozicion për arsye të vonesave në terren dhe procesimin e të dhënave. Është e nevojshme të zhvillohet një plan i detajuar i punës për ASN-të me afatet kohort dhe përgjegjësitë, duke filluar nga dizajnimi i pyetësorit deri te publikimi i rezultateve, përfshirë vlerësimin e mostrës, organizimin e grumbullimit të të dhënave, futjen e të dhënave dhe procesin e validimit, ngritjen në nivel vendi dhe diseminimin e të dhënave.

Aneksi 1



Projekti i Binjakëzimit i BE-së

KS12 IB ST 01

Përkrahje për Statistikat

Termat e Referencës:

Komponenti 2: Llogaritë Kombëtare

Activity 2.3.1.2: Vazhdim i përkrahjes për implementimin e Planit të Veprimit

Afatet:

Ter –data e finalizimit: 03 Nëntor 2014

Fillimi / fundi i aktivitetit: 17-21 Nëntor 2014

Koha e raportimit: 28 Nëntor 2014

Rezultatet obligative të komponentit:

Rezultatet obligative	Intervenimi logjik	Standardet	Burimet e informacionit	Supozimet
2.3.1.2	Vazhdim i përkrahjes për implementimin e Planit të Veprimit	Raporti i misionit që përshkruan punën e bërë dhe punën që duhet të bëhet, i publikuar në web faqen e projektit	- Raportet tremujore të Projektit të Binjakëzimit - Raporti i Misionit - Plani i veprimit, i azhurnuar	- Kapacitet i mjaftueshëm absorbimi - Numër i vogël i stafit i involvuar në implementim - Stafi punon në realizimin e detyrave, që lidhen me projektin, në mes te

				misioneve • Qasje në statistika primare të qarta • Termat e references, të përpiluara me kohë, që paraqesin në detaje detyrat, (inputi), rezultat e pritura, pjesëmarrësit në aktivitet dhe agjendën
--	--	--	--	---

Subjekti / qëllimi i aktivitetit: 2.3.1.2

Ky mision është vazhdim i misionit 2.2.1.1

Konsultimet dhe diskutimet e mëtejme me njësinë e Llogarive Kombëtare.

Harta rrugore për Llogaritë Kombëtare në tabelën nr.2 në raportin e misionit nga aktiviteti 2.1.1 (Vlerësimi dhe azhurnimi i Planit të Veprimit) nga Graversen dhe Ungureanu, ofron një plan të detajuar të hapave të nevojshëm. Plani i punës i përpiluar vitin e kaluar nga ASK dhe i aprovuar nga Qeveria ka parashikuar të realizohen vlerësimet e BPV-së vjetore sipas qasjes së shpenzimeve deri në Shtator, dhe sipas qasjes së prodhimit deri në Nëntor të vitit 2013. Në praktikë këto dy qasje akoma publikohen në kohë të ndryshme. Një nga objektivat e projektit të binjakëzimit do të jetë vlerësimi dhe publikimi i BPV-së sipas qasjes së prodhimit dhe shpenzimeve në të njëjtën kohë, në formë të balansuar; kjo mund të realizohet në vitin 2015.

Rezultate e pritura nga aktiviteti 2.3.1.2

Raporti i misionit. Përkrahje për vlerësimin e BPV-së sipas qasjes së prodhimit, bazuar në ESA 2010 për vitin 2013

Trajnim në vendin e punës mbi Llogaritë Kombëtare

Stafi i ASK-së:

Xhevdie Fetahu, Shefe e Divizionit të Llogarive Kombëtare, Xhevdie.Fetahu@rks-gov.net

Ylli Shala, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Ylli.Shala@rks-gov.net

Ilir Mazrekaj, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Ilir.Mazrekaj@rks-gov.net

Emine Bajrami, Zyrtare e lartë e Llogarive Kombëtare, Emine.Bajrami@rks-gov.net

Florije Krapi, Zyrtare e lartë e Llogarive Kombëtare, Florije.Krapi@rks-gov.net,

Nysret Sylejmani, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Nysret.Sylejmani@rks-gov.net

Besim Mehmeti, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Besim.Mehmeti@rks-gov.net

Ilir.T. Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare, Ilir.T.Berisha@rks-gov.net

Ekipi i Binjakëzimit i ASK-së:

Udhëheqës i projektit Z. Ilir T. Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare, Ilir.T.Berisha@rks-gov.net

Homologu i RTA, Znj. Teuta Zyberi, Zyrtare e Lartë për Marrëdhënie me Jashtë, teuta.zyberi@rks-gov.net

Ekspertët e vendeve anëtare:

Znj. Clementina Ivan-Ungureanu, Ekspert, Statistikat e Danimarkës, iu_clem@yahoo.com

Ekipi i Projektit të Binjakëzimit:

Z. Per Knudsen, RTA, pkn@dst.dk

Znj. Nora Zogaj, RTA asistente, nzogaj@yahoo.com

Përshkrimi i historikut për aktivitetet

Raporti i Vlerësimit të Adaptuar Global i vitit 2012 (AGA) i përgatitur nga Eurostat-i deklaron në lidhje me Llogaritë Kombëtare (f. 53-54): Në vitin 2010, ASK me mbështetjen e IPA përgatiti një 'Plan të veprimit për përpilimin dhe publikimin e statistikave të plota për llogaritë kombëtare dhe tregun e punës'. Ky plan është në parim një instrument i dobishëm për organizimin dhe zhvillimin e ardhshëm të Llogarive Kombëtare së bashku me zhvillimin e standardeve dhe burimeve, që janë të nevojshme për rritjen e mbulueshmërisë dhe përmirësimin e të dhënave të llogarive kombëtare.

AGA më tej deklaron që në parim përmirësimi dhe rritja e mbulueshmërisë së Llogarive Kombëtare vjetore duhet të jetë prioriteti i parë i ASK-së. Kalkulimi i BPV-së duke përdorur qasjet e prodhimit dhe të shpenzimeve është i rëndësishëm së veçantë.

Aktivitetet e pritura janë:

Analizimi i burimeve të të dhënave në dispozicion për vlerësimin e BPV-së sipas qasjes së prodhimit për vitin 2013, në çmime aktuale dhe konstante
Përkrahja për vlerësimin e BPV-së për vitin 2013, sipas qasjes së prodhimit

Rezultatet e pritura:

- Raporti i misionit – sipas modelit për raportim

- Rekomandimet për aktivitetet e mëtejme për të siguruar arritjen e qëllimit të rishikimit të llogarive vjetore sipas qasjes së prodhimit.

Aneksi 1. Programi, Nëntor 2014

Dita	Vendi	Koha	Ngjarja
1	ASK	09.00-16:00	Planifikimi i javës
			Analizimi i aktiviteteve të realizuara nga misioni i kaluar në Shtator
			Pushim për kafe
			Analizimi i aktiviteteve të realizuara nga misioni i kaluar në Shtator – vazhdim
2	ASK	09:00-12.00	Analizimi i burimeve të të dhënave në dispozicion për vlerësimin e BPV-së sipas qasjes së prodhimit për vitin 2013
		12.00-13.00	Dreka
		13.00-17.00	Analizimi i burimeve të të dhënave në dispozicion për vlerësimin e BPV-së sipas qasjes së prodhimit për vitin 2013 - vazhdim
3	ASK	09:00-12.00	Diskutimi i vlerësimeve të para për BPV-së sipas qasjes së prodhimit për vitin 2013
		12.00-13.00	Dreka
		13.00-17.00	Diskutimi i vlerësimeve të para për BPV-së sipas qasjes së prodhimit për vitin 2013 – vazhdim
4	ASK	09:00-12.00	Përmirësimet e vlerësimeve të para për BPV-në sipas qasjes së prodhimit
		12.00-13.00	Dreka
		13.00-17.00	Përmirësimet e vlerësimeve të para për BPV-në sipas qasjes së prodhimit – vazhdim
5	ASK	09:00	Përmirësimet e vlerësimeve të para për BPV-në sipas qasjes së prodhimit – vazhdim
		10:30	Pauza për kafe
		10:00	Rekomandimet për aktivitetet e mëtejme
		12:00	Dreka
		13:15-17.00	Takim mes ekspertëve, udhëheqësit të komponentit dhe RTA

Aneksi 2. Personat e takuarASK:Llogaritë kombëtare

Ilir Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike,

Xhevrie Fetahu, Shefe e Divizionit të Llogarive Kombëtare,

Ylli Shala, Ilir Mazrekaj, Emine Bajrami Florije Krap, Nysret Sylejmani, Besim Mehmeti

Ekipi i Projektit të Binjakëzimit :

Per Knudsen, RTA

Nora Zogaj, RTA Asistente